



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2176/2 prot,

Datë 06.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64461-03-31-2023, me objekt: “*Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 26.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime Shkodër SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “*PRIMUS ALBANIA*” SHPK me NIPT: L42202028V dhe me adresw: *Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati “Viridario I”, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Ujësjellës-Kanalizime Shkodër SH.A
Adresa: Lagjia “3 Heronjte”, Rr. “Marin Biçikemi” Shkodër.

Në datën 06.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3396 dhe me nr. 2176/2023 protokoli, datë 06.09.2023 e bashkimi të operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*” për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64461-03-31-2023, me objekt: “*Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 26.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime Shkodër SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*”.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PRIMUS ALBANIA SHPK & Nexia AL Consulting SHPK*” kundërshton me anë të ankesës me nr. 2176 prot., datë 06.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kriteve për Kualifikim OE duhet: të paraqesë vërtetim të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohet vlera, afaati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore e shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi. Primus Albania nuk ka paraqitur një vërtetim të tillë.

Referuar pikës 2.3.1 pika b) të Kriteve për Kualifikim OE duhet të paraqesë faturë tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nexia Consulting nuk ka paraqitur një dokument të tillë.

Referuar pikës 2.3.2 të Kriteve për Kualifikim OE duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. OE duhet të paraqesë kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat. Në kundërshtim me këtë pikë OE nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacionet e sipërcituara.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**